

S T A T U T I

I SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE ME EMERTIMIN

"IMMO-INVEST" SH.A.

PSHATI STACIONI ZOOTEKNIK XHAFZOTAJ DURRES



1. Shoqeria anonime pa oferte publike eshte shoqeria, kapitali i se ciles ndahet ne aksione dhe qe themelohet ndermjet orta-keve qe perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vlefte se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar me dy ortake :

Z. Roland Wallaert , lindur ne Belgjike ne vitin 1937, dhe banues ne 8500 Kortrijk, Dam 10, Belgjike. I pajisur me pasaporte Nr. 562761, me cilesine e drejtorit te shoqerise

Z. Fabrice Wallaert lindur ne Belgjike ne vitin 1967, dhe banues ne 8500 Kortrijk, Dam 10, Belgjike. I pajisur me pasaporte 232606, me cilesine e kryetarit te keshillit mbikqyres.

2. Te deklaruar ortake ne kete shoqeri, u muaren vesh ndermjet tyre sa me poshte :
3. Shoqeria do te emertohet "IMMO-INVEST" sh.a; pa oferte publike shoqeria eshte person juridik dhe e fiton kete te drejte mbareneshkrimit te ketij statuti nga ortaket themelues dhe regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe ne organet e Tatim Taksave Durres.

4. Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj mbi bazen e legjisla-cionit shqiptar, ne baze te ligjes Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", ligjin Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar".

Kreu V-te, nga nenet 74 deri ne nenin 294, per shoqerite anonime, si dhe ne baze te dispozitave te parashikuara ne dokumente e krijimit te shoqerise (Statuti, Kontrata e Themelimit, rregullore)

[Handwritten signature]

./..

[Handwritten signature]

lloret, vendimet e marra nga asamblea e ortakeve, keshilli mbikqyres, etj.)

5.

Selia e shoqerise do te jete ne fshatin Stacioni zooteknik Xhafzotaj Durres. Shoqeria mund te krijoje filiale, dege e perfagesi brenda teritorit te Shqiperise dhe jashte saj.

6.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet

7.

Objekti i veprimtarise se shoqerise "IMMO-INVEST" sh.a, do te jete :

Shoqeria ka per objekt administrimin e nje pronesie te patundeshme kryesisht nga blerja, shitja, dhenia me qira, ose marreveshje te tjera qe kane per qellim perdorimin, venien ne pune ose ne lidhje me pasurine e patundeshme, vleresimin dhe shtrirjen e kesaj pasurie te patundeshme, venien e likuideve me vlere, dhe pasurine e patundeshme e te tundeshme.

Shoqeria mund te beje çdo operacion financiar te pasurise se tundeshme e te patundeshme, qe lidhen direkt ose indirekt, teresisht ose pjeserisht me objektin social ose qe do te kish- te nje natyre te tille ne menyre qe te thjeshtoje realizimin e ketij veprimi.

Ajo gjithashtu mund, pa kufi, te shese, te bleje, te jape me qira ose te marre me qira, t'ia jape me qira nje te treti, te ndertoje vete ose nepermjet te tjereve, te transformoje ose pajise pronen e patundeshme e cila eshte per t'u shitur, rishit- tur ose per t'u dhene me qira. Pervec kesaj shoqeria ka per objekt prodhimin, eksportimin, importimin e materialeve te nder- timit te çdo natyre qofshin.

Ajo mund te marre pjese nepermjet ndihmash, neneshkrimesh, shkrirjes ose te ndonje menyre tjeter ne te gjitha shoqerite dhe ndermarrjet ekzistuese ose qe do te krijohen



./.. 

ne teritorin Shqiptar dhe ne çdo vend tjeter.

Ajo mund te jape garanci reale ose personale per te tretet.

8. Kapitali themeltar i shoqerise anonime "IMMO-INVEST" sh.a. eshte 2.000.000 (dymilion) leke, dhe konkretisht pjeset e ortakeve ne te jane :

Z.Roland Wallaert me 1.000.000 leke ose 50 perqind.

Z.Fabrice Wallaert 1.000.000 leke ose 50 perqind.

9. Vlera e mesiperme e kapitalit themeltar perbehet nga 200 aksione me vlere nominale 10.000 sejcila, qe jane baraz me 200 vota. Sejcilit ortak i takon nga 100 vota. Sa me siper i perkasin sejcilit ortak sipas kapitalit themeltar te marre persiper dhe depozituar prej tyre. Me zgjerimin e aktivitetit te kesaj shoqerie kapitali themeltar mund te rritet duke u shtuar numri i aksioneve nga palet (ortaket).

Organet drejtuese te shoqerise anonime jane :

1. Asamblea e aksionareve
2. Keshilli mbikqyres
3. Drejtoria

10. Asamblea e aksionareve perbehet nga ortaket pjesmarres ne kapitalin themeltar te shoqerise anonime.
11. E drejta e votes se çdo ortaku ne mbledhjen e asamblese eshte ne raport te drejt me kontributin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.
12. Ne mbledhjen e pare te asamblese se zakoneshme zgjidhet keshilli mbikqyres i shoqerise anonime "IMMO-INVEST" sh.a.



./..





Vetem asamblea e jashtezakoneshme ka kompetenca te ndryshoje statutin me te gjithë dispozitat e tij. Çdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefshme.

Asamblea e jashtezakoneshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 1/2 e aksioneve, dhe ne te dyten 1/4 e aksioneve me te drejte vote.

Ajo merr vendim me nje shumice votash prej 3/4 qe u perkasin aksionareve te pranishem ose te perfaqesuar.

14. Asamblea e zakoneshme merr çdo vendim, perveç atyre qe permen- den ne nenin 13 te ketij statuti.

Asamblea e zakoneshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar

15. Asamblea e zakoneshme thirret ne mbledhje te pakten nje he- re ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit finan- ciar. Ky afat mund te zgjatet me vendim gjyqesor.

Pas leximit te raportit, drejtoria i paraqet asamblese lloga- rite vjetore, dhe ne rast se eshte e nevojshme, llogarite e konsoliduara.

Asamblea shqyrton dhe vendos mbi te gjithë çeshtjet financia- re te vitit financiar qe ka kaluar.

16. Mbledhja e asamblese thirret nga keshilli mbikqyres ose nga drejtoria.

Ne mungese ajo mund te thirret gjithashtu :

- Nga ekspertet kontabel te autorizuar
- Nga nje mandatmbajtes, i caktuar nga gjyqi, me kerkesen e nje personi te interesuar per nje rast urgjent, ose te nje apo disa aksionareve qe zoterojne se bashku te pakten 1/10 e kapitalit themeltar
- Nga likujduesit.

Mbledhjet e asamblese te aksionareve mbahen ne seline e sho- qerise.



17.

Thirrja e mbledhjeve te asamblese se aksionereve, behet nepermjet lajmerimit qe botohet ne nje gazete te autorizuar per publikimin e njoftimeve ligjore.

Njoftimi qe duhet te bjere ne doren e aksionareve apo te njihet prej tyre, te pakten 15 dite perpara se te behet mbledhja e asamblese ,percakton ditën, orën dhe vendin ku do te behet mbledhja, si dhe natyren e jashtezakoneshme, te zakoneshme apo te veçante dhe rendin e dites .

18.

Nje aksionar mund te perfaqesohet nga nje tjeter aksionar apo nga bashkeshorti. Mandati jepet vetem per nje mbledhje asambleje. Ai nderkaq mund te jepet per dy mbledhje asambleje, nga te cilat nje e zakoneshme dhe tjetra e jashtezakoneshme, qe mbahet ne te njejten dite ose brenda 7 ditesh.

Mandati i dhene per nje mbledhje asambleje eshte i vlefshem per mbledhje te tjera te asamblese, te cilat thirren ne vazhdim me te njejten rend dite.

19.

Ne çdo mbledhje te asamblese plotesohet nje evidence pjesmarrjeje. Ecuria e mbledhjes se asamblese pasqyrohet ne procesverbal. Shenimet qe mbahen ne evidencen e pjesmarrjes dhe ne procesverbal, si dhe rregullat e ruajtjes se tyre percaktohen me ligj te veçante.

20.

Mbledhja e asamblese se zakoneshme mund t'u caktoje anetareve te keshillit mbikqyres si shperblim nje shume vjetore fikse per pjesmarrjen e tyre ne seancat e ketij keshilli. Ky shperblim perballohet nga llogaria e shoqerise.

21.

Asambleja e jashtezakoneshme eshte kompetentja e vetme per te vendosur ne mbledhjen e saj zmadhimin e kapitalit mbi bazen e raportit te drejtorise.



./...



Ne mbledhjen e zakoneshme asamblea emeron ekspertet kontabel per kontrollin e shoqerise anonime "IMMO-INVEST" Sh.A.

Prishja e shoqerise shpallet ne mbledhjen e asamblese se jashtezakoneshme, kryesisht kur ajo merr nje vendim te tille, per aresye se ajo nuk do te zhvilloje me tej aktivitetin e saj, si dhe ne rastin e falimentimit te shoqerise "IMMO-INVEST" Sh.A.

Ne mungese te mbledhjes se asamblese se jashtezakoneshme, ashtu dhe ne rastin kur ajo asamble nuk ka mundur te marre vendim te vlefshem ne mbledhjen e fundit, çdo i interesuar mund te kerkoje prishjen e shoqerise ne rruge gjyqesore.

24. Ne mbledhjet e asamblese se aksionareve, mund te marrin pjese anetaret e keshillit mbikqyres, anetaret e drejtorise dhe ekspertet kontabel, me vota konsultative. Ata kane vote vendimore vetem kur e zoterojne ate me cilesine e aksionareve. Ata duhet te njoftohen me shkrim brenda afatit te caktuar.

25. Asamblea nuk mund te shqyrtoje nje çeshtje qe nuk percaktohet ne rendin e dites. Megjithate ajo mund te shkarkoje nje apo disa anetare te keshillit mbikqyres dhe te procedoje per zevendesimin e tyre ne çdo rrethane.

26. Ne mbledhjen e pare te asamblese se zakoneshme u zgjedhen anetaret e keshillit mbikqyres per 6 vjet, dhe konkretisht :
- Fabrice Dorssan Michel Wallaert, lindur ne Belgjike 1967
- Veronique Eliane Berth Wallaert, lindur ne Tielt te Belgjikes me 02.11.1964, me banim ne Della Faillelaan 47 Nr.2020 Antwerpen Belgjike. Me karte identiteti Nr.002 0725323 12.
- Loncke Jacqueline Dorssane, lindur ne Ingelmunster Belgjike me 26.09.1941, me banim ne 8500 Kortrijk, Dam 10, Belgjike me karte identiteti Nr.209 0103367 38.

./...

27.

Keshilli mbikqyres i shoqerise "IMMO-INVEST" Sh.A. ne mbledhjen e saj zgjodhi kryetarin e saj z. Fabrice Wallaert.

28.

per 6 vjet, dhe do te drejtoje debatin gjate seancave te tij Keshilli mbikqyres perbehet nga jo me pake se tre anetare, dhe jo me shume se 21. Numri i anetareve duhet te jete i plotepjestueshem me tre.

29.

Asnje anetar i keshillit mbikqyres nuk mund te jete anetar i drejtorise. Ne rast se nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise, mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon sapo ai te kaloje ne funksionin e ri.

30.

Keshilli mbikqyres emeron drejtorin e saj. Drejtori i shoqerise mund te zgjidhet edhe jashte bashkesise se aksionareve. Per rastin konkret drejtor i kesaj shoqerie u zgjodh zoti Roland Wallaert, dhe do te qendroje ne krye te kesaj drejtorise per nje kohe prej 6 vjetesh me te drejte rizgjedhje.

31.

Statuti i shoqerise "IMMO INVEST" Sh.A. i njeh keshillit mbikqyres te drejten per tu dhene drejtorit ose ndonje personi tjeter qe mund te emerohet me pas ne drejtori, kompetencen e perfaqesimit te shoqerise vetem apo se bashku me nje anetar tjeter.

32.

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj drejtorise per administrimin e shoqerise nga ana e saj. Perfundimi i operacioneve te renditura ne statut mund te behet me autorizim paraprak te keshillit mbikqyres. Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne qdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe ai i qmon te aresyeshme dhe te kekoje te njihet me dokumentat qe ai i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij. Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

./...

33. Dy te tretat e anetareve te keshillit mbikqyres emerohen nga mbledhja themeluese e ortakeve ose nga mbledhja e zakoneshme e asamblese. Kryetari i keshillit mbikqyres i emeruar nga mbledhja e zakoneshme e asamblese per 6 vjet, ka te drejten te rizgjidhet mbas mbarimit te ketij afati. Po ashtu si kryetari i keshillit mbikqyres ashtu dhe anetaret e tij mund te shkarkohen ne qdo moment nga asamblea e zakoneshme.
34. Nje person juridik mund te emerohet ne keshillin mbikqyres. Ai duhet te caktoje nje perfaqesues te perhershem qe u nenshtrohet po atyre kushteve dhe detyrimeve dhe ka te njejtat pergjegjesi civile e penale, sikur te ishte ai vete anetar i keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjesia e perbashket personin juridik qe ai perfaqeson.
35. Kur numri i anetareve te keshillit mbikqyres ka zbritur nen minimumin ligjor, drejtoria dihet te therrase urgjentisht mbledhjen e zakoneshme te asamblese per te plotesuar vendet bosh ne keshillin mbikqyres.
36. Nje e treta e anetareve te keshillit mbikqyres zgjidhet nga te punesuarit ne shoqeri. Ne se numri i anetareve te keshillit mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit eshte i barabarte ose me i madh se 2, inxhinjere, kuadro ose personat e ngjajshem me ta kane te pakten nje vend ne keshillin mbikqyres.
37. Te gjitha te punesuarit e shoqerise, qe kane lidhur kontraten e punes mbi tre muaj perpara dates se zgjedhjeve, konsiderohen si zgjedhes. Votimi eshte i fshehte.
38. Mandati i anetarit te keshillit mbikqyres i zgjedhur nga te



./..



punesuarit nuk humbasin avantazhet qe u jep kontrata e punes. Shperblimi i tyre si te punesuar nuk mund te pakesohet nga fakti qe ata ushtrojne kete mandat.

39. Prishja e kontrates se punes i jep fund mandatit te anetarit te keshillit te zgjedhur nga te punesuarit.
Prishja e kontrates se punes te nje anetari te keshillit mbikqyres, te zgjedhur nga te punesuarit, me perjashtim te rastit kur kjo prishje behet me iniciativen e tij, shpallet nga gjykata, qe mblidhet ne seance urgjente. Vendimi ekzekutohet perkohesisht derisa ai te marre formen e prere.
40. Keshilli mbikqyres mund te caktoj shperblime te jashtezakonshme per sherbimet apo detyrat qe u besohen anetareve te keshillit mbikqyres.
Anetaret e keshillit mbikqyres, me perjashtim te atyre qe zgjidhen nga te punesuarit, nuk mund te marrin prej shoqerise as nje shperblim, te perhershem ose jo.
41. Kryetari i keshillit mbikqyres ka keto detyra :
- Te mbikqyre te gjitha funksionet e shoqerise
- Te vendosi per çdo problem qe ka lidhje me shoqerine
- Te perfagesoje shoqerine ne maredhenie me te tretet brenda veprimtarise te percaktuar ne objektin e saj
- Te neneshkruaje çdo dokument publik ose privat ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj
- Te marri vendime per gjenjen e metodave me te efekteshme per nje kosto te ulet e te dobishme ne marrjen e huave me afat te gjate shlyerje.
42. Mbledhjet e keshillit mbikqyres kryesohen nga kryetari i saj.
43. Unanimiteti per marrjen e vendimeve nga keshilli mbikqyres

kerkohet per qeshtjet e meposhteme :

- Celja e nje kredie ne monedha shqiptare ose te huaja
- Aprovimi i politikës së çmimeve
- Percaktimi i numrit të punonjesve dhe pagat e tyre
- Percaktimi i kompetencave të drejtorit të shoqërisë.

44. Keshilli mbikqyres ka kompetenca të marre vendime për çdo problem që ka lidhje me drejtimin e shoqërisë dhe realizimin e objektivave të saj, me përjashtim të çështjeve që janë në kompetencën ekskluzive të asamblese së aksionareve. Vendimet e keshillit mbikqyres janë të vlefshme kur janë marre me shumicë absolute votash. Kur një anëtar nuk merr pjesë për pamundësi, mund të caktojë me shkrim një përfaqësues të tij çdonjerin prej anëtarëve të keshillit mbikqyres. Vendimet e marra nga keshilli mbikqyres pasqyrohen në një bllok të veçantë dhe nënshkruhet prej kryetarit, sekretarit dhe të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje.
45. Në fund të çdo viti (periudhë) ekonomike financiare, keshilli mbikqyres mbyll llogaritë, miraton regjistrimin e detajuar të pasurisë së shoqërisë, miraton bilancin dhe harton një relacion shkoqites për zhvillimin e aktivitetit ekonomik financiar të shoqërisë për vitin e ardhshëm kalendarik. Bilanci ekonomik financiar i shoqërisë duhet të dalë dhe të dorëzohet në organet financiare të Tatimit dhe Taksave brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
46. Shoqëria anonime "IMMO INVEST" Sh.A. drejtohet nga drejtori i vetëm i saj, zoti Roland Wallaert.
47. Drejtoria ushtron funksionet e saj nën kontrollin e keshillit mbikqyres të shoqërisë anonime.



./..



48. Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres, ne rast se ai, me mbatimin e mandatit 6 vjeçar nuk rizgjidhet, si dhe per shkaqe te perligjura.
49. Drejtori ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise.
50. Shoqeria ne maredhenie me te tretet merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorise, edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise e kalonte objektin e shoqerise.
51. Ankesat apo kerkesat qe te tretet i adresojne shoqerise, jane te vlefshme kur ato drejtohen te drejtori.
52. Drejtori eshte pergjegjes, individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te dispozitave ligjore ose te rregulloreve te zbatueshme per shoqerite anonime, per shkelje te statutit, si dhe per gabimet e bera ne administrimin e shoqerise anonime.
53. Anetaret e drejtorise dhe anetaret e keshillit mbikqyres perveç atyre qe jane persona juridike, ndalohet te kontaktojnë ne cilendoforme, qe te marrin hua nga shoqeria, te japin ne permjet saj paredhenie, si dhe te behen dorezenes apo te garantojne nepermjet saj detyrimet ndaj te treteve. Çdo kontrate e bere ne kundershtim me ndalimet e mesiperme eshte i pavlefshem.
54. Anetaret e drejtorise dhe te keshillit mbikqyres, si dhe çdo person qe thirret te marre pjese ne mbledhjet e ketyre organeve, duhet te ruajne fshehtesine per te dhenat qe kane karakter te brendshem dhe qe cilesohen si te tille nga kryetari.
- ./..

55.

Ne çdo shoqeri anonime kontrolli ushtrohet nga nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar dhe te emeruar nga asamblea e zakoneshme ne mbledhjen e saj. Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen per nje vit financiar. Funksionet e tyre perfundojne pas mbledhjes se asamblese se zakoneshme, e cila merr vendim mbi llogarite vjetore.

56.

Ekspertet kontabel te autorizuar garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta e te hartuara me sinqeritet dhe japin nje pasqyrim besnik te rezultatit te operacioneve te vitit te kaluar financiar, si dhe te gjendjes financiare te trashegimise se shoqerise ne fund te ketij viti financiar.

57.

Ne çdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar, se bashku ose veç e veç, bejne te gjitha verifikimet e kontro- llet qe i gjykojne te nevojshme, dhe per rezultatet e kontro- llit informojne drejtorine dhe keshillin mbikqyres. Ndersa ne mbledhjen me te afert te asamblese sinjalizojne per pa- rregullsite dhe pasaktesite e gjetura. Ekspertet kontabel te autorizuar sigurohen qe eshte respek- tuar barazia ndermjet aksionereve.

58.

Ekspertet kontabel te autorizuar jane pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvleftesimet e tyre ne ushtrimin e funksioneve perkatese.

59.

Aktiviteti ekonomik financiar i shoqerise "IMMO INVEST" Sh. ndahet ne periudha, te cilat zgjasin 12 muaj. Çdo periudhe fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtut vit kalendarik.

60.

Shoqeria krijon fonde rezerve dhe fonde te tjera te veçanta



./..



per zhvillimin ekonomik, industrial, te shtimit te pasurive te patundeshme, etj. te saj.

61.

Fitimi neto i shoqerise del pasi nga te ardhurat e saj zbriten te gjitha shpenzimet qe jane bere gjate vitit kalendarik dhe pasi te jene paguar taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera te shoqerise sipas ligjit financiar, fitimi do te ndahet ne raport me perqindjen e aksioneve qe ka sejcili ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise.

62.

Shoqeria eshte ne likujdim e siper qe ne momentin e prishje se saj per cfaredolloje aresye.

63.

Emertimi i shoqerise pasohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim e siper". Ky shenim dhe emri i likujduesit ose likujduesave duhet te figurojne ne te gjitha aktet e dokumentet e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohet te treteve.

64.

Ortaket thirren ne fund te procesit te likujdimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise per administrimin nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likujdues, si dhe per te evidencuar mbylljen e likujdimit.

65.

Ne qofte se mbledhja e asamblese se aksionareve te shoqerise anonime nuk mund te marre vendim ose ne qofte se ajo nuk pranon te miratoje llogarite e likujduesit ose likujduesave, vendimi merret nga gjykata me kerkesen e likujduesi ose te qdo personi te interesuar.

66.

Likujduesi depoziton llogarite e tij ne regjistrin tregetar ku qdo i interesuar mund te njihet me to dhe perkundrejt pageses te marre nje kopje prej tyre.



./..





67. Llogarite perfundimtare te hartuara nga likujduesi depozitohen ne aneksin e regjistrit tregetar. Ketu bashkengjitet vendimi i asamblese se ortakeve per keto llogari, per aktin e rregullshmerise per administrimin nga ana e likujduesit dhe heqjen e manfatit te tij si likujdues.
68. Njoftimi i mbylljes se likujdimit publikohet sipas modaliteve te percaktuara me ligj te veçante.
69. Shoqeria çregjistrohet nga regjistri tregetar mbasi kryhen formalitetet e parashikuar ne legjislacion.
70. Ne se aksionaret e asamblese, themelues te shoqerise anonime "IMMO INVEST" sh.a., konkretisht zoterinjte Roland Wallaert dhe Fabrice Wallaert, kerkojne mbylljen e aktivitetit te kesaj shoqerie, atehere do te kryhen te gjitha veprimet procedurale ligjore. Pastaj shoqeria "IMMO INVEST" Sh.A. e marre nga aksionare te rinj eshte e detyruar tu ktheje atyre qe largohen vleren ne monedha te huaja (dollare, etj.) ose ne konvertim te tyre me leke, te te gjitha kapitaleve te krijuara nga pasurite e patundeshme, siç eshte e gjithë siperfaqja e trualli, e objekteve te ndertuara ne te, dhe pasurite e tundeshme siç jane materialet dhe lendet e para gjendje, etj. te cilat figurojne ne inventaret dhe ne dokumentacionet financiare baze te kesaj shoqerie.
71. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin, ne rast se nuk mund te zgjidhen me mirekuptim ndermjet ortakeve, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte gjykata shqiptare.
72. Statuti u perpilua ne pese kopje, dhe te gjithë kane te njejtën permbajtje ligjore.

Durres, me 08.01.1998

O R T A K E T
ROLAND WALLAERT
Roland Wallaert

FABRICE WALLAERT
FABRICE WALLAERT